



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

01Nr. 16-9727/16
Kaçanik, 29.04.2016

Në bazë të nenit 12, 17(e) të Ligjit Nr.03/L-040- Për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28 e datës 4 qershor 2008), lidhur me nenin 19 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-233- Për Mbrojtjen e Natyrës (Gazeta Zyrtare Nr. 85 e datës 9 nëntor 2010), të nenit 6 lidhur me nenin 34.5 e Statutit të Komunës së Kaçanikut, si dhe Rekomandimit të Agjensionit për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë Nr.3644/15, të datës 14.07.2015, i cili vepron në kuadër të MMPH, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 29 prill 2016, merr këtë:

V E N D I M
PËR MBROJTJEN E VLERËS SË NATYRËS HUMNERA NË SHPATIN E QENARES
TË GLLBOÇICË SI MONUMENT I NATYRËS

1. Me këtë Vendim merret nën mbrojtje vlera e natyrës **Humnera në Shpatin e Qenares** në fshatin Gllboçicë të Kaçanikut si monument i natyrës i karakterit speleologjik (këtu e tutje: Monumenti i Natyrës).

1.1. Monumenti i Natyrës me hapësirën përfshirëse të zonës buferike prej 10m. përfshinë sipërfaqen prej **1 hektarë**.

1.2. Monumenti i Natyrës i karakterit speleologjik. Deri më tani monumenti nuk është hulumtuar. Pas hyrjes horizontale 2metra, ka një zhvillim vertikal.

2. Monumenti i Natyrës gjendet në fshatin Gllboçicë, në lartësinë mbidetare 1032m, Zona Kadastrale Gllboçicë, parcela nr. 495-0, pronë private e Ramadan Lumës, koordinatat LAT: 42.169561, LONG: 21.210302, sipërfaqja 1113m², me kulturë arë e klasit 8.

3. Monumenti i Natyrës sipas IUCN - it kategorizohet si vlerë e natyrës e kategorisë së III - të, Natural Monument / Natural Landmark - Monument i Natyrës.

4. Për Monumentin e Natyrës përcaktohet regjimi mbrojtës i shkallës së III-të, të mbrojtjes në të cilën përcaktohen masat dhe kushtet vijuese me të cilat:

4.1. Në Monumentin e Natyrës ndalohet:

4.1.1. Dëmtimi, shkatërrimi, bartja e shtresimeve të mineraleve ose fosileve, bota e gjalle e objektit speleologjik, gjetjet arkeologjike, fosileve dhe gjetjeve tjera, ndryshimi i kushteve të vendbanimit në objekt mbi të dhe në afërsi të drejtpërdrejtë të tij.

4.2. Për të gjitha aktivitetet në objektin speleologjik duhet të merret leja nga Ministria e veçanërisht për:

4.2.1. Shfrytëzimi dhe rregullimi i objektit speleologjik dhe pjesëve të tij;

4.2.2. Hapja dhe/ose mbyllja e hyrjes/ daljes në objektin speleologjik si dhe për ndërtimin, përtëritjen ose sanimin e çdo objekti nëntokësor,

4.2.3. Kryerja e hulumtimeve shkencore dhe profesionale,

- 4.2.4. Zhytja në objekt speleologjik,
- 4.2.5. Xhirimi i filmave në objektet speleologjike,
- 4.2.6. Punët dhe veprimtaritë të cilat ndikojnë në veçoritë themelore, në florën dhe faunën natyrore në objektin speleologjikose në/mbi sipërfaqen e tij;
- 4.2.7. Vizitat e organizuara dhe fotografimi në objekt speleologjik,
- 4.3. Për kryerjen e hulumtimeve shkencore dhe profesionale, shoqatave speleologjike mund t'iu lëshohet leja një (1) vjeçare;

4.4. Vendimi për leje përmban edhe kushtet për mbrojtjen e natyrës.

4.5. Në Monumentin e Natyrës lejohen:

4.5.1. Të gjitha masat e mbrojtjes së Monumentit të Natyrës nën kushtet të cilat i përcakton Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe në bazë të Projektit për sanimin e gjendjes së Monumentit të Natyrës si dhe punët teknike të cilat janë në funksion të mbrojtjes të Monumentit të Natyrës.

5. Në zonën buferike të Monumentit të Natyrës ndalohet:

- 5.1. Lëshimi i ujërave të ndotura, deponimi i mbeturinave dhe mbetjeve të tjera,
- 5.2. Përdorimi i mjeteve mbrojtëse kimike,
- 5.3. Ndërrimi i kulturës,
- 5.4. Mbjella e bimëve ose ngritja e objekteve të cilat mundën me ndikuar në pengimin e pamjes të Monumentit të natyrës.

5.4.1. Zona buferike e Monumentit të Natyrës si dhe hapësira rrethuese mund të rregullohet dhe të shfrytëzohet për qëllime të prezantimit me kusht që destinimet e reja nuk e rrezikojnë Monumentin e Natyrës.

6. Për zbatimin e masave dhe kushteve të përcaktuara, kujdeset Komuna e Kaçanikut. Kujdestari është i detyruar:

- 6.1. Monumentin e Natyrës ta mbroj, ta ruaj dhe mirëmbajë në pajtim me kushtet e përcaktuara të mbrojtjes,
- 6.2. Në rast të paraqitjes të ndryshimeve të cilat Monumentin e Natyrës mundën ta shkatërrojnë ose t'i dëmtojnë vetitë e rëndësishme të tij, menjëherë të lajmëroj Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës,
- 6.3. Të bëjë shënjimin e kufijve të Monumentit të Natyrës në pajtim me Rregulloren për Shënjimin e Zonave të Mbrojtura.

7. Planet hapësinore dhe urbanistike, projektet, bazat ekonomiko-pyjore, hidroekonomike duhet të harmonizohen me masat dhe kushtet për mbrojtjen e Monumentit të Natyrës.

8. Ky Vendim pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të autoritetit mbikëqyrës – MAPL, si dhe pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.

9. Me këtë Vendim shfuqizohet Vendimi i mëhershëm 01. nr. 16-30578/15, i datës 29.09.2015.

Kryesuesi i Kuvendit
Xhela Gashi

